

Përmbledhje e masave për menaxhimin e rasteve pozitive

Këshilli i Ministrave, me dekret-ligj nr. 5 i datës 4 shkurt 2022, miratoi “Masa urgjente lidhur me certifikatat e vaksinimit COVID-19 dhe me kryerjen e aktiviteteve në fushën e sistemit arsimor, shkollor dhe të edukimit” dhe vendosi **rregulla të reja** mbi karantinën në **shkollë**.

Në vijim lista përmbledhëse e masave të reja:

Siç shpjegohet në deklaratën e Këshillit të Ministrave, në lidhje me karantinën në shkollë ka një dallim në qoftë se rastet shfaqen në kopshte, shkolla fillore (scuola primaria ose elementare), shkolla të mesme (scuola secondaria di primo dhe secondo grado ose scuola media dhe superiore).

Vendoset se:

- **Në kopësht - shërbime arsimore për fëmijë të vegjël**

Në qoftë se shfaqen

Deri në 4 raste nxënësish pozitiv ndaj COVID- 19	Më shumë se 5 raste nxënësish pozitiv ndaj COVID- 19 në të njëjtin seksion
<ul style="list-style-type: none">- aktivitetet vazhdojnë në prani fizike- Pasi klasa të ketë marrë veshë për rastin e fundit të konfirmuar pozitiv ndaj Covid-19, mësuesit dhe edukatorët do të përdorin maska FFP2 në dhjetë ditët në vijim.- Nëse shfaqen simptoma, është e detyrueshme për nxënësit të kryejnë një test të shpejtë (test antigenico rapido) në farmaci ose të kryer vetë me një kit shtëpiak, ose një test molekular.- Nëse ende shfaqen simptoma të COVID 19, testi duhet të përsëritet nga dita e pestë pas kontaktit të fundit që keni pasur me një person që ka rezultuar pozitiv ndaj Covid-19, dhe pozitiviteti është konfirmuar.	<ul style="list-style-type: none">- aktivitetet arsimore në prani fizike do pezullohen për një periudhë 5 ditore.- Pasi klasa të ketë marrë veshë për rastin e fundit të konfirmuar pozitiv ndaj Covid-19, mësuesit dhe edukatorët do të përdorin maska FFP2 në dhjetë ditët në vijim.- Nëse shfaqen simptoma, është e detyrueshme për nxënësit të kryejnë një test të shpejtë (test antigenico rapido) në farmaci ose të kryer vetë me një kit shtëpiak, ose një test molekular.- Nëse ende shfaqen simptoma të COVID 19, testi duhet të përsëritet nga dita e pestë pas kontaktit të fundit që keni pasur me një person që ka rezultuar pozitiv ndaj Covid-19, dhe pozitiviteti është konfirmuar.

- **Në shkollat fillore (scuola primaria)**

Në qoftë se shfaqen

Deri në 4 raste nxënësish pozitiv ndaj COVID-19 në të njëjtin seksion	Më shumë se 5 raste nxënësish pozitiv ndaj COVID-19 në të njëjtin seksion
<ul style="list-style-type: none"> - vazhdohen të ndiqen aktivitetet arsimore në prani fizike. Mësuesit dhe nxënësit mbi 6 vjeç do përdorin maska FFP2 deri në ditën e dhjetë pasi është marrë veshë për rastin e fundit të konfirmuar pozitiv ndaj Covid-19. - Është e detyrueshme të kryhet një test i shpejtë në farmaci ose një test vetë në shtëpi ose test molekular direkt pas shfaqjes të simptomave të para dhe nëse ende vazhdoni të shfaqni simptoma, testi duhet të përsëritet në ditën e pestë pas kontaktit të fundit që keni pasur me një person që ka rezultuar pozitiv ndaj Covid-19. 	<ul style="list-style-type: none"> - për ata që e kanë kryer ciklin e vaksinimit nga më pak se 120 ditë ose që janë shëruar nga covid nga më pak se 120 ditë ose që kanë bërë dozën e tretë të vaksinimit, aktivitetet arsimore vazhdojnë në prani fizike dhe për dhjetë ditë mësuesit dhe nxënësit mbi 6 vjeç do përdorin maska FFP2; - për të gjithë studentët e tjerë, aktivitetet arsimore do vazhdojnë online për 5 ditë.
<p>Për të qëndruar në klasë, mjafton të tregohet certifikata e vaksinimit (e quajtur Greenpass ose certificazione verde) e cila do të kontrollohet nëpërmjet një app nga telefoni.</p>	

- **Shkollat e mesme (scuola secondaria di primo dhe secondo grado)**

Në qoftë se shfaqet

një rast pozitiv midis studentëve të së njëjtës klasë	një ose më tepër raste pozitive midis studentëve të së njëjtës klasë
<ul style="list-style-type: none"> - aktiviteti arsimor vazhdon për të gjithë në prani fizike dhe nxënësit dhe mësuesit duhet të përdorin maska FFP2 	<ul style="list-style-type: none"> - Të vaksinuarit dhe ata që janë shëruar nga më pak se 120 ditë ose pas ciklit të vaksinimit fillestar (dy doza), të vaksinuarit që kanë kryer dozën përforcuese (doza e tretë) dhe ata që për arsye shëndetësore nuk duhet të vaksinohen, do vazhdojnë aktivitetin arsimor në prani fizike duke përdorur maska FFP2 për dhjetë ditë; për të gjithë nxënësit e tjerë, aktivitetet shkollore vazhdojnë online për 5 ditë.
<p>Për të qëndruar në klasë, mjafton të tregohet certifikata e vaksinimit (e quajtur Greenpass ose certificazione verde) e cila do të kontrollohet nëpërmjet një app nga telefoni.</p>	

Regjimi shëndetësor

Me pesë apo më shumë raste pozitive në shërbimet arsimore për fëmijët e vegjël, në kopshte dhe në shkollën fillore dhe me dy raste pozitive apo më shumë në shkollën e mesme (scuola secondaria di I e II grado), fëmijët dhe nxënësit duhet të ndjekin regjimin shëndetësor të vetë-monitorimit (**autosorveglianza**).

Vetë-monitorimi (apo vetë-diagnoza) nuk e detyron një person që ka pasur kontakt të ngushtë me një pozitiv të qëndrojnë në shtëpi duke pritur të verifikojë nëse është apo jo pozitiv ndaj virusit, por ky person ka mundësi të dalë e të jetojë "normalisht" duke respektuar disa masa paraprake:

* Për pesë ditë pas kontaktit të ngushtë me dikë që ka rezultuar pozitiv, personi (që është vaksinuar ose shëruar nga më pak se 120 ditë, ose që ka kryer tashmë dhe dozën e tretë të vaksinimit) mund të dalë pa pasur nevojë të qëndrojnë në karantinë, por duhet të bëjë vetë një diagnozë për të vlerësuar gjendjen shëndetësore personale;

* Parashikohet kryerja e një tamponi të shpejt ose molekular për të zbuluar pozitivitetin ndaj virusit sapo të shfaqen simptomat e para (përfshirë gripi) dhe nëse ende keni simptoma, duhet të kryhet një tampon në ditën e pestë nga momenti i kontaktit të fundit të afërt me persona që janë konfirmuar si raste pozitive ndaj Covid 19.

Testet mund të kryhen edhe në qendra private të autorizuara, por operatori që kryen analizat dhe diagnozën duhet të dërgojë raportin negativ në ASL-in përkatës për të lejuar përfundimin e vetë-monitorimit.

Vetë-monitorimi është i vlefshëm për të vaksinuarit dhe ata që janë shëruar nga më pak se 120 ditë ose për persona që kanë kryer ciklin e vaksinimit fillestar (doza 1 dhe doza e dytë), që janë vaksinuar me dozën e tretë (doza përforcuese ose booster), përndryshe duhet të zbatohet regjimi shëndetësor i **karantinës për pesë ditë**, e cila përfundon me një tampon negativ. Për pesë ditët e ardhshme pas kthimit nga karantina, nxënësit nga mosha 6 vjeçare e lart duhet të përdorin maska ffp2.

QARKULLIMI I TË HUAJVE NË ITALI

Të gjitha personat që vijnë nga një shtet i huaj dhe kanë një certifikatë shërimi apo vaksinimi me një vaksinë të autorizuar (Pfizer, Astra Zeneca Jahnsen, Moderna) ose të njohur si ekuivalente në Itali (Covishield -Serum Institute of India-, prodhuar me licencë nga Astra Zeneca, R-CoVI (R-Pharm), prodhuar me licencë nga Astra Zeneca, CCovid-19 vaccine-recombinant (Fiocruz), prodhuar me licencë nga Astra Zeneca), nëse kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj që nga përfundimi i ciklit të vaksinimit ose shërimit, lejohet hyrja në shërbime dhe aktivitete për të cilat nevojitet certifikata e përforcuar (Green Pass Rafforzato) ashtu si dhe pasi kryhet një test i shpejtë (vlefshmëri 48-orë) ose molekular (vlefshmëri 72-orë).

Kjo vlen edhe për ata që kanë kryer vaksinimet me vaksinat e paautorizuara ose që nuk konsiderohen ekuivalente në Itali, gjithnjë pasi kanë bërë një tampon.